



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN DHE NJOFTIMIN ME PUBLIKUN

Nr. 2154 prot

Roskovec , më 18 03 . 2026

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Në bazë të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit Nr 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 18, të Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike,

Ju njoftojmë se do të zhvillohen dëgjesa publike me temë:

“PËR NJË SHITESË NË PAKETËN FISKALE 2026”

Takimet do të zhvillohen, përkatësisht:

- Ditën e Premte datë 10.04.2026, ora 14:00 në Njësinë Administrative Strum, fshati Suk 2 pranë Njesisë,
- Ditën e Premte, datë 10.04.2026 ora 15:00 në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Roskovec

Ftojme të gjitha grupet e interesit si : qytetar, biznese, fermer, grupet e marginalizuara, të rinjë/reja, shoqëria civile, të bëhen pjesë e këtyre dëgjesave për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen deri më datë 10 Prill 2026 në adresat e mëposhtme të emailit:


Paola.goga@bashkiaroskovec.gov.al Koordinator për Njoftim dhe Konsultim Publik
Arlinda.hajdini@bashkiaroskovec.gov.al Sekretari i Këshillit

**Kjo dëgjesë do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak ku do të
marin pjesë përfaqësues të Këshillit Bashkiak.**

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin!

**K R Y E T A R
MAJLINDA BUFI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR
MAKSIM GOGA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE

Nr. _____ prot.

Roskovec, më ____ . ____ .2026

PROJEKT-VENDIM

NR ____ .DATE ____ . ____ .2026

“PËR NJE SHTESE NE PAKETËN FISKALE PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore” gërma “f”, të nenit 54, ; Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Ligjit 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” ; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit 10081 datë 23.02.2009 “Për Licensat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, Ligjin 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, Ligjin nr 93/2015 “Për turizmin”, Ligjin nr 8098 datë 23.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, Ligji nr 9506 datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, Ligjit nr 8153 datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit” Ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, Ligjin 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, Ligjin nr 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin nr 10296 “Për manaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr.408, date 13.05.2015 “Per miratimin e rregullores se zhvillimit të territorit”, si dhe VKB nr.70 date 24.12.2025 ***“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2026”***

Ju paraqesim për diskutim e miratim:

1. Nje shtese mbi nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 si më poshtë vijone :

Ne KAPITULLIN II "TARIFAT VENDORE", pika II.3 "Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave", Tabela 2. "Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për bizneset dhe institucionet", pas pikes f te shtohen pikat g-m si me poshte :

Nr	Bizneset(sipas llojit të aktivitetit)	Qyteti
		Roskovec
	SUBJEKTE NDËRTIM	
	A) Subjekte ndërtuese me selinë administrative	100,000
	B) Subjekte ndërtimi sipas investimi dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit	
a)	Për vlera investim deri në 5,000,000 lekë	30,000
b)	Për vlera investim nga 5,000,001 lekë-15,000,000 lekë	60,000
c)	Për vlera investim nga 15,000,001 lekë-25,000,000 lekë	90,000
d)	Për vlera investim nga 25,000,001 lekë-50,000,000 lekë	120,000
e)	Për vlera investim nga 50,000,001 lekë-100,000,000 lekë	150,000
f)	Për vlera investim nga 100,000,001 lekë - 200,000,000 lekë	225,000
g)	Për vlera investim nga 200,000,001 lekë – 500,000,000 lekë	300,000
h)	Për vlera investim nga 500,000,001 lekë – 1,000,000,000 lekë	500,000
i)	Për vlera investim nga 1,000,000,001 lekë – 2,000,000,000 lekë	1,000,000
j)	Për vlera investim nga 2,000,000,001 lekë – 5,000,000,000 lekë	1,500,000
k)	Për vlera investim nga 5,000,000,001 lekë – 10,000,000,000 lekë	2,000,000
l)	Për vlera investim nga 10,000,000,001 lekë – 15,000,000,000 lekë	2,500,000
m)	Për vlera investim mbi 15,000,000,000 lekë	3,000,000

2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe administrata e bashkise për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.

Konceptoi: Selman Çepele

Marjola Dardha

Enrida Gishti

Xhoana Sakaj

Rajmonda Çela

KRYETAR
Majlinda BUFI